



**Deklaratë për shtyp - 392/05/2020**

18.05.2020  
Faqja 1 nga 2

## **#IchDuWirNRW: Njerëzit shembullorë i japin shtysë solidaritetit social në pandeminë e koronavirusit**

Zyra për shtyp e kancelarisë së shtetit  
40213 Düsseldorf  
Telefon 0211 837-1134  
0211 837-1405  
ose 0211 837-1151

[presse@stk.nrw.de](mailto:presse@stk.nrw.de)  
[www.land.nrw](http://www.land.nrw)

**Muzikanti Eko Fresh dhe moderatorja Nazan Eckes mbështesin fushatat e integrimit dhe japin shembullin e mbajtjes së më shumë përgjegjësive për njëri-tjetrin**

**Ministria e Fëmijëve, Familjes, Refugjatëve dhe Integrimit ju informon:**

Shoqata e integrimit dhe e vlerësimit #IchDuWirNRW ka bërë fushatë që nga 2018 për më shumë solidaritet shoqëror, pavarësisht origjinës së gjithësecilit. Në kohën e pandemisë së koronavirusit, mirëkuptimi reciprok dhe konsiderata janë më të rëndësishme se kurrë. Kjo është pikërisht arsyeja pse pesë njerëz shembullorë të integrimit nga Nordrhein-Westfalen po bëjnë thirrje në 6400 postera përgjatë Republikës për të mbajtur më shumë përgjegjësi për njëri-tjetrin dhe për t'ju përmbytur rregullave të tanishme për koronavirusin si përsëmbull rregulli i distancës dhe larja me themel e duarve.

Midis tyre janë ndër të tjerë edhe moderatorja e televizionit Nazan Eckes dhe reperi Eko Fresh .

„Pandemia e koronavirusit është një sfidë e madhe për të gjithë ne. Gjithësesi, jam i bindur se mund të dalim më të fortë si shoqëri nëse qëndrojmë të bashkuar, e trajtojmë njëri-tjetrin me respekt dhe ndjekim rregullat të cilat na mbrojnë nga virusi. Ne duam t'ju inkurajojmë me fushatën tonë . Nordrhein-Westfalen është një republikë e fortë. Nëse do të vazhdojmë të tregojmë konsideratë dhe të mbështesim njëri-tjetrin , do ta kapërcejmë pandeminë “, sqaroi Ministri i Integrimit Joachim Stamp tek zbulimi i posterit në Düsseldorf.

Serap Güler, Sekretarja e Shtetit për Integrimin: „Pjesëmarrja nënkupton gjithashtu mbajtjen e përgjegjësive për njëri-tjetrin. Qytetarët tanë shembullorë #IchDuWirNRW janë përfaqësues për miliona njerëz të Republikës sonë, të cilët pasurojnë shoqërinë tonë me historitë e tyre të

emigracionit. Duke filluar nga oficerët e policisë, tek stafi administrativ e deri tek trajnerët e futbollit, ata e bëjnë të qartë se të vepruarit me solidaritet nuk është çështje origjine .“

„Tani është e rëndësishme të mbrojmë njëri-tjetrin. Ata të cilët nuk ndjekin rregullat vendosin të tjerët në rrezik. Këtë gjë duam patjetër ta parandalojmë. Fushata #IchDuWirNRW vendos një fokus të veçantë tek kjo gjë dhe i adresohet njerëzve në një mënyrë shumë emocionale. Nuk ka rëndësi nëse jemi të rinj apo të vjetër, koronavirusi është një shqetësim i përbashkët. Është detyra e gjithësecilit prej nesh që të sigurohemi që ne dhe njerëzit tanë të qëndrojnë të shëndetshëm gjatë pandemisë“, u shpreh Eko Fresh.

Fushata #IchDuWirNRW ka nisur në 2018 dhe me një total prej më shumë se 40 personash nga mjedise të ndryshme kulturore, tregon se sa mirë ecën integrimi në Nordrhein-Westfalen dhe cilat mundësi kanë njerëzit me dhe pa histori emigracioni në NRW pavarësisht disa sfidave. Do të vazhdojë deri në fund të periudhës legjislative.

### **Na ndiqni në rrjetet sociale:**

Twitter: [@chancenrw](https://twitter.com/chancenrw)

Facebook: [Chancen NRW](https://www.facebook.com/ChancenNRW)

Instagram: [chancen\\_nrw](https://www.instagram.com/chancen_nrw)

YouTube: [Chancen NRW](https://www.youtube.com/ChancenNRW)

***Nëse keni pyetje të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni zyrën e shtypit të Ministrisë së Fëmijëve, Familjes, Refugjatëve dhe Integrit, Telefon 0211 837-2417.***

***Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion në internet në adresën e internetit të qeverisë së Republikës [www.land.nrw](http://www.land.nrw)***

**[Njoftim për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me rrjetet sociale](#)**